



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Shkrim Akademik

Ngarkesa: 4 ETCS, 40 orë seminare

Viti akademik, semestri kur zhvillohet: Viti I, semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor në Gjuhë Angleze

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Kjo lëndë ofron një hyrje gjithëpërfshirëse në Shkrimin Akademik, duke përfshirë procesin e shkrimit, elementët kryesorë të shkrimit, llojet kryesore të eseve, paragrafët, praktikën e studentëve në lloje të ndryshme të shkrimit, etj. Ky kurs i prezanton studentët e vitit të parë të studimeve universitare me bazat e shkrimit akademik. Studentët do të mësojnë të lexojnë në mënyrë kritike, të shkruajnë qartë dhe të zhvillojnë argumente në formate të strukturuar akademike. Theksi vihet në procesin e shkrimit, integritetin akademik dhe komunikimin efektiv brenda pritjeve të nivelit universitar.

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Pas përfundimit me sukses të këtij kursi, studentët do të jenë në gjendje të:

Identifikojnë dhe zbatojnë komponentët kryesorë të shkrimit akademik (ideja kryesore e esesë, fjalitë tematike, lidhëzat etj.).

Hartojnë ese dhe raporte akademike të strukturuar mirë të përshtatura për audienca dhe qëllime specifike.

Integrojnë burimet dytësore në mënyrë efektive dhe etike në punën me shkrim.

Përdorin stilet e citimit akademik në mënyrë korrekte për të shmangur plagjiaturën.

Vlerësojnë në mënyrë kritike tekstet akademike dhe u përgjigjen atyre në formë të shkruar.

Të demonstrojnë gramatikë, fjalor dhe sintaksë të përmirësuar në kontekste akademike.

Të reflektojnë mbi procesin e tyre të shkrimit dhe të zbatojnë rishikime bazuar në reagime.

Të komunikojnë idetë qartë dhe bindshëm në anglishten akademike të shkruar